

PLATFORMA
E
KANDIDATIT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

OBJEKTIVAT DHE STRATEGJIA PERSONALE

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është një institucion kushtetues, vendimmarrës që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve. Me krijimin e tij ndodhemi në një moment kyç të zbatimit të reformës në drejtësi, të ngritjes së institucioneve të reja të prokurorisë shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, me qëllimin arritjen e një drejtësie efektive, forcimin e ligjit dhe të shtetit të së drejtës dhe që do të rivendosë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

Tashmë është e njohur situata aktuale në të cilën po kalon sistemi i drejtësisë në Shqipëri. Reforma në të cilën është përfshirë ky sistem dhe nga e cila marr shkas dhe unë për të hyrë në këtë procedurë kandidimi më shtyn akoma më tepër të bëhem pjesë e personave që duan të kontribuojnë për realizimin e saj dhe përmbushjen e qëllimit të mbarë opinionit publik për të pasur një sistem drejtësie të pavarur, të paanshëm dhe të përbërë nga prokurorë me integritet dhe vlera të larta etike, morale dhe profesionale, si dhe që i përkasin të vërtetës dhe të drejtës.

Një faktor i identifikuar tashmë nga analiza e sistemit të drejtësisë dhe që ka ndikuar në gjendjen e sistemit të drejtësisë, ka qenë prania e lartë e korrupsionit në sistem, parashikimet e legjislacionit, mënyra e organizimit dhe funksionimit të organeve të drejtësië, në veçanti të institucionit të Prokurorisë, si një institucion me vartësi të drejtëpërdrejtë duke ndikuar në mënyrë negative në vendimmarrje dhe në pavarësinë e prokurorit.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një nga pikësynimet strategjike dhe objektiv kombëtar për Republikën e Shqipërisë dhe për arritjen e këtij objekti nevojitet angazhim maksimal dhe përpjekje të vazhdueshme në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare dhe se ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian është marrë angazhim për përgatitjen e reformave të nevojshme për procesin e integritit në Bashkimin Evropian ku Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka një përgjegjësi të veçantë, që kanë të bëjnë me një sërë objektivash dhe masash, të cilat duhet t'i ndërmerren. Sfidat ime, si Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të jetë në vazhdimësi, që drejtësia të jetë në dispozicion të qytetarit, që të fitojmë besimin e e tij, duke mundësuar një protagonizëm e monitorim të aktivitetit ligjor të institucionit të prokurorisë, si dhe duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri maksimale në përmbushjen e detyrave tona si institucion.

Në harmoni me të gjithë dokumentet strategjikë të mësipërm, strategjia personale si anëtar i KLP do të jetë që të arrijmë të rrisim pritshmërinë e publikut dhe të partnerëve tanë, nëpërmjet objektivave të mëposhtëm, të cilat konsistojnë në:

- Rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të drejtësisë, për arritjen e një sistemi drejtësie të pavarur, cilësor, të besueshëm, transparent dhe të aksesueshëm prej publikut.
- Sigurimin e pavarësisë së sistemit të prokurorisë, fuqizimin e pavarësisë të prokurorëve, me qëllim që ato të jenë të pavarur nga çdo lloj ndikimi dhe presioni.
- Lufta e hapur ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet ku gjendet.
- Konsolidimi i garancive të statusit të prokurorit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në funksionin të detyrës.

Angazhimi im për realizimin e këtyre objektivave do të ndodhë duke qenë tepër aktiv në realizimin e mekanizmave ligjorë të parashikuar në funksion të këtij Këshilli, tek propozimet e mia në nxjerrjen e akteve nënligjore të Këshillit, përmes masave konkrete:

- Ofrimi i eksperiencës personale për hartimin e planifikimit strategjik të sistemit të prokurorisë;
- Dhënien e kontributit në miratimin e standarteve të etikës dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre.
- Ndërmarrjen e nismave lidhur me procesin e vlerësimit etik dhe profesional për prokurorët, ngritja e sistemit të pikëzimit.
- Ndërmarrja e nismave dhe ofrimi i bashkëpunimit për përmirësim të sistemit të inspektimit.
- Studimi dhe konsolidimi i eksperiencave me qëllim vendosjen e një standardi për rritje të garancive për promovimin në karrierën e prokurorëve.
- Nismave për rritje të garancive për procedim disiplinor të prokurorëve duke parashikuar garanci që mundësojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, përcaktimin e qartë të shkaqeve për përgjegjësi disiplinore.
- Propozimit për marrjen e të gjitha masave të domosdoshme për krijimin e infrastrukturës ndihmëse në prokuroritë, në mënyrë që të arrihet funksionimi normal i tyre në funksion të drejtësië;
- Nismave për miratimin e rregullave standarde për funksionimin e brendshëm të prokurorisë.

- Nismave për përmirësimin e trajtimit financiar, të infrastrukturës dhe kushteve të punës për prokurorët.

SFIDAT

Në përfundim, duke vlerësuar se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si institucion që ka një përgjegjësi dhe angazhim të drejtpërdrejtë në organizimin, kontrollin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë, është një nga instrumentet kryesore, për të analizuar sfidat me të cilat ndeshet sistemi i prokurorisë, si anëtar i këtij Këshilli, unë do të angazhohem personalisht nëpërmjet nismave, propozimeve dhe ofrimit të ekspertizës personale për të konkluduar për objektivat dhe standardet që do të duhen arritur dhe ndjekur.

Sfida ime personale do të jetë luftimi i praktikave të këqija të deritanishme, aspak transparente dhe jo të drejta, duke tentuar drejt rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, drejt mbrojtjes së dinjitetit dhe respektit të vetë prokurorëve në këtë sistem. Do të bëj maksimumin për të garantuar integritetin moral dhe profesional të çdo prokurori. Qëndrimet e mia në procedurat e promovimit, transferimit, ngritjes në detyrë do të bëhen vetëm mbi bazën e meritokracisë, integritetit moral dhe profesional. Arsytet dhe argumentet e mia do të mbështeten në të dhëna të prekshme të punës së secilit prokuror, do jem mbështetës i një gjykimi të drejtë dhe të shëndoshë në përcaktimin dhe dhënien e vlerave të secilit prokuror në çfarëdo shtate të paraqitur.

